

P.nr.3645/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtaren ligjore Valmire Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E.B. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajten e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 4008/18 të datës 28.08.2018, jashtë seancës, me datë 11.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 4008/18 të datës 28.08.2018 për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

E.B., i ati E.1 dhe e ëma I. e gjinisë E., i lindur mëdt: ..., në P., me vendbanim në rr. "T.B.", i pa martuar, menaxher, i gjndjës së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqipëtar, - shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datën 05/07/2018, rreth orës 23:59, në rrugën "I.K." te Komuna e vjetër në P., i pandehuri E.B., derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës "Peugot", ngjyrë e verdh metalike, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoi komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, duke rrezikuar jetën e njërzeve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 31.1 të Ligjit mbi bazat e sigurisë së trafikut, /Nr.05/L-88/, i cili ka qenë i ndalur dhe ka filluar të kyçet në rrugë në mënyrë të pasigurt, pa u bindur mirë se këtë veprim mund ta kryej pa i penguar dhe pa i rrezikuar pjesmarrësit tjerë në trafik, duke mos e respektuar shenjat horizontale të trafikut, i njejt nga shiriti i djathtë i rrugës kalon vijen e plot/ të panderprerë/del në shiritin e majtë të rreth rrotullimit, me ç'rast në shiritin e majtë ka qenë duke lëvizur motoçiklisti "BR 8 Taiw Golden", ngjyrë e kuqe, pa targa, të cilën motoçikletë e drejtonte i dëmtuari E.O., i cili ne pamundësi që ti shmanget aksidentit, me pjesën e përparme e godet automjetin "Peugot", në pjesën e parë anësore të anës së majtë, i cili ishte në shiritin e vet qarkullues, me ç'rast lëndime të lehta trupore pësojnë drejtuesja e motoçikletës "BR 8 Taiw Golden", E.O. dhe shkaktohet aksident komunikacioni me dëme materiale,-

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

Nëshumë prej **260 (dyqind e gjashtëdhjetë) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se ipandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **20** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

I dëmtuari: E.O., i lindur me ..., me vendbanim në rr. "K.Ll.", P., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 4008/18 të datës 28.08.2018, kundër E.B.nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, teakuzuarit sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit B.G. e datës 01.08.2018, Ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.V.K. të datës 09.08.2018, Raporti i aksidentit, me nr. 0244019, të datës 05.07.2018, Deklarta e të dëmtuarit, Deklarta e të pandehurit, Kallëzimi Penal, skica nga vendi i ngjarjës, fotodokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.3645/18 të dt:11.10.2018

Zyrtare Ligjore,
Valmire Ahmetaj

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.